

VENDIM

Nr. 12 Date 15.04.2015

PER MIRATIMIN E RREGULLORES SE PROÇEDURAVE PER DHENIEN E
“TITUJVE VENDOR TE NDERIT”

Keshilli i Qarkut Kukës në mbledhjen e tij të datës së mesipërme, pasi shqyrtoi Relacionin dhe P/Vendimin e paraqitur nga Drejtoria Juridike, Finances dhe MBNJ-se, bazuar në Kushtetuten e Republikës së Shqipërisë, nën 113/1/dh, ligjin Nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” nën 7/2, 8/1/l/b, 8/1/vii/a, 54/m, ligjin Nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ligjit Nr. 112/2013, të miratuar me datë 04.04.2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë” nën 14,15,16 si dhe VKM Nr.861, datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, si dhe vendimin e Kryesise së KQK-se Nr.4, datë 15.04.2015 “Për miratimin e P/Akteve për mbledhjen e Keshillit të Qarkut Kukës”,

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloren mbi proçedurat e dhenies së “Titujve Vendor të Nderit”, bashkangjitur këtij vendimi.
2. Vendimi i Keshillit të Qarkut Kukës Nr.9 datë 12.02.2013 “Për miratimin e Rregullores mbi proçeduren e dhenies së - Titujve të Nderit”, shfuqizohet.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari, Sekretari i Keshillit të Qarkut Kukës, Drejtoria Juridike, Finances dhe MBNJ-se si dhe Komisioni Këshillimor.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Konc: E. Cahani

Ligjshmeria: G. Çejku

Sekretari: B. Ngjeçi

U hartua në 3 (tre) kopje origjinale:

1. Zyres së Protokoll Arkivit
2. Institucionit të Prefektit të Qarkut

KRYETARI

Ibsen ELEZI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I QARKUT KUKES

RREGULLORE
MBI PROÇEDURAT PER DHËNIEN E TITUJVE VENDOR TË NDERIT

Kjo rregullore është hartuar në bazë të Kushtetutes se Republikës se Shqipërisë, neni 113/1/dh, ligjit Nr.8652, date 31.07.2000 “Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” nenet 7/2, 8/1/1/b, 8/1/VII/a, 54/m, ligjin Nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Proçedurave Administrative të RSH-se”, ligjin Nr.112/2013, te miratuar me date 04.04.2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë” nenet 14,15,16 si dhe VKM Nr.861, date 10.12.2014 “Per miratimin e rregullave te hollesishme per funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, nepermjet se ciles percaktohen rregullat dhe proçedurat për dhenien e “Titujve Vendor të Nderit” nga Keshilli i Qarkut Kukës.

Neni 1

Hyrje

Titujt vendor të nderit u jepen individëve dhe personaliteteve te ndryshme, në përshtatje me kontributet dhe vlerat, rolin dhe ndikimin e tyre në opinionin publik.

Neni 2

Titujt e Nderit

1. Keshilli i Qarkut Kukës jep keta tituj nderi:

- a. Nderi i Qarkut Kukës
- b. Personalitet i shquar ne fushen..... (emri i fushes)

Keta tituj jane te barazvlefshem dhe jepen duke marrë parasysh shkallën e rëndësisë së veprimtarisë dhe kontributit te personit te propozuar.

2. Kryetari i Keshillit te Qarkut, jep kete titull nderi:

- a. Çertifikate (Mirenjohje)

Neni 3

Pershkrimi i Titujve te Nderit

NDERI I QARKUT KUKES: I jepet çdo personaliteti shqiptar ose të huaj për veprimtari të shquar në dobi të qarkut apo për veprimtari për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të tij.

PERSONALITET I SHQUAR: U jepet qytetareve shqiptar dhe te huaj per veprimtari te spikatur ne fushat e ndryshme te shkences, artit, arsimit, kultures dhe sportit ne dobi te Qarkut Kukës.

MIRENJOHJE: U jepet qytetareve shqiptarë dhe te huaj ne shenje nderimi dhe falenderimi per kontributin dhe veprimtarine e tyre ne dobi te Qarkut Kukës



REPUBLIKA E SHQIPERISE

KESHILLI I QARKUT KUKES

Neni 4

E drejta e propozimit per dhenies se titujve te nderit

Te drejten per te propozuar dhenien e titujt te nderit e ka çdo njesi e qeverisjes vendore, çdo anëtar i Këshillit të Qarkut, drejtues te institucioneve publike, organizatat jofitim-pruresse, te cilet nepermjet kesaj te drejte synojnë të evidentojnë e nxisin kontribute e vlera të veçanta në dobi të shoqërisë si dhe për të vlerësuar e respektuar mbartësit e tyre.

Neni 5

Propozimi per dhenie titull nderi

1. Propozimi duhet të dërgohet jo më vonë se 90 ditë kalendarike përpara datës së propozuar për dhënien e dekoratës, titullit të nderit, medaljes ose titullit vendor të nderit, me përjashtim të rasteve të veçanta kur respektimi i këtij afati është bërë objektivisht i pamundur
2. Propozimi për dhenie titull nderi është i plotë dhe shqyrtohet në kohën e duhur kur plotëson kriteret e mëposhtme:
 - a. Kur propozimi firmoset nga titullari i institucionit që ka të drejtën e propozimit ose nga perfaqesuesi i shoqërisë civile.
 - b. Shoqërohet me relacionin përkatës, ku paraqiten arritjet dhe meritat e veçanta të propozuarit.
 - c. Përmban CV-ne e personit dhe arsyetimin rreth motivacionit.
 - d. Letër pranimit e titullit të nderit nga personi perkates.
 - e. Si dhe dokumenta te tjere plotesues që vërtetojnë përmbushjen e kriterëve përkatëse për dhënien e dekoratës, titullit të nderit, medaljes ose titullit vendor të nderit.
3. Në aktin e propozimit përcaktohen:
 - a. Autoriteti propozues dhe baza ligjore për propozimin.
 - b. Emri, mbiemri dhe prezantimi i personit të propozuar.
 - c. Arsyet e hollësishme që çojnë në propozimin e personit.
 - d. Lloji i dekoratës, titullit të nderit, medaljes ose titullit vendor të nderit.
 - e. Vërtetim se personi i propozuar nuk është dënuar ndonjëherë për shkelje të rënda të ligjit ose nuk është nën hetim.
 - f. Në rastin e dekoratave, vërtetimi se personit të propozuar nuk i është dhënë më parë një dekoratë e njëjtë ose më e lartë se ajo e propozuar.

Neni 6

Kriteret e propozimit

Të propozuarit për dhenien e titullit të nderit, në përputhje me titullin e propozuar, duhet të kenë arritje, kontribute dhe vlera të veçanta në shërbim dhe në dobi të Qarkut Kukës.

- a. Propozimi bëhet duke mbajtur parasysh meritat e individit në përputhje që ai të jetë në përshatje me llojin e titullit, vlerat e ndikimit në opinionin publik
- b. I njëjti titull nuk mund të jepet dy herë.
- c. Nuk mund të jepet titull më e ulët nga një titull më i lartë i dhënë më parë
- d. Propozimi nuk mund të bëhet për ata persona që janë të dënuar për shkelje të ligjit ose

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I QARKUT KUKES

Neni 7

Motivacioni i titullit

Per çdo propozim per dhenie titull nderi, motivacioni duhet te jete i veçante, i plote dhe ne menyre te permbledhur.

Neni 8

Komisioni Keshillimor

1. Për dhënien e titujve vendorë të nderit, sipas legjislacionit në fuqi, prane Keshillit të Qarkut Kukës krijohet një Komision Këshillimor, në vijim "Komisioni", të përbërë prej 5 (pesë) anëtarësh, prej të cilëve 3 (tre) anëtarë duhet të jenë punonjës në varësi të autoritetit përgjegjës dhe 2 (dy) anëtarë personalitete të jashtme, që përzgjidhen mes njerëzve të shquar dhe që kanë dhënë kontribut në fushën përkatëse.
2. Komisioni Keshillimor do të perbehet nga:
 - a. Drejtori i Drejtorise Juridike, Finances dhe MBNJ-se
 - b. Juristi i Drejtorise Juridike, Finances dhe MBNJ-se
 - c. Keshilltari për Marrredheniet me Jashte, Qeverisjen Vendore & OJF-te
 - d. Personalitet i jashtem ne fushen e.....
 - e. Personalitet i jashtem ne fushen e.....
3. Emerimi nominal i antareve të "Komisionit Keshillimor" do të behet me urdher të Kryetarit të Keshillit të Qarkut.

Neni 9

Organizimi dhe funksionimi i Komisionit Keshillimor

Komisioni, në mbledhjen e tij të parë, zgjedh, me shumicë votash, Kryetarin dhe Sekretarin e tij. Kryetari drejton mbledhjen, drejton diskutimet, siguron zbatimin e ligjit dhe marrjen e vendimeve të drejta.

- a. Lajmërimet për thirrjen e mbledhjeve bëhen brenda 10 (dhjetë) ditëve, pas paraqitjes së kërkesës dhe, të paktën, 48 orë para datës së thirrjes së mbledhjes.
- b. Lajmërimi për thirrjen e një mbledhjeje duhet të tregojë, në mënyrë të qartë dhe të detajuar, çështjet për të cilat do të diskutohet, orën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes.
- c. Mbledhja është e vlefshme edhe kur nuk respektohen procedurat e parashikuara më sipër, vetëm në rast se në atë mbledhje marrin pjesë të gjithë anëtarët, të cilët, paraprakisht, miratojnë zhvillimin e mbledhjes.
- d. Mbledhjet e komisionit zhvillohen kur janë të pranishëm shumica e anëtarëve të tij.

Neni 10

Shqyrtimi i propozimit

1. Komisioni Këshillimor verifikon nëse akti i propozimit përmban të gjitha elementet e percaktuara në këto rregullore.
2. Nëse propozimi nuk është i plotë, Komisioni Këshillimor kërkon me shkrim, brenda 15 ditëve kalendarike nga data e marrjes së propozimit, plotësimin e të njëjtit.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I QARKUT KUKES

3. Nëse propozimi është i plotë, Komisioni Këshillimor paraqet mendimin e tij pranë Autoritetit Përgjegjës brenda 30 ditëve nga data e marrjes së propozimit.
4. Nëse propozimi është i plotë, komisioni këshillimor paraqet mendimin e vet pranë Autoritetit Përgjegjës (Keshillit të Qarkut) brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së propozimit.
5. Në çdo rast, procedurat për shqyrtimin e dhënies së titullit vendor të nderit, nuk mund të zgjatin më shumë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike.
6. Proçesi i shqyrtimit të propozimit mund të shtyhet apo të pezullohet përkohësisht për rrethana të paparashikuara, që dëmtojnë reputacionin dhe vlerën e dhënies së titullit të nderit, në opinionin publik, deri në sqarimin e këtyre rrethanave.

Neni 11

Proçedura e miratimit

1. Të gjitha propozimet për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit i dërgohen Autoritetit Përgjegjës për dhënien e tyre, i cili i përcjell për vlerësim në Komisionin Këshillimor.

Komisioni shqyrton propozimet dhe merr vendimin me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Votimi është i hapur. Anëtarët e komisionit, që janë të pranishëm në mbledhje, nuk mund të abstenojnë. Kryetari i Komisionit Këshillimor voton i fundit.

2. Në çdo mbledhje mbahet një proçes-verbal, në të cilin pasqyrohen data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që marrin pjesë, çështjet që diskutohen, vendimet e marra, si dhe mënyra dhe rezultati i votimeve.

3. Komisioni Këshillimor gjatë shqyrtimit të propozimeve për dhënie titull vendor nderi, zbaton të gjitha rregullat e hollësishme të percaktuara në VKM Nr.861 datë 10.12.2014.

Neni 12

Refuzimi i propozimit

Kur propozimi për dhënien e titullit vendor të nderit, nuk miratohet, Komisioni Këshillimor i bën njoftimin autoritetit propozues për mos-miratimin.

I njëjti propozim nuk mund të bëhet pa kaluar 1 (një) vit kalendariq nga njoftimi i refuzimit të propozimit.

Neni 13

Organizimi i ceremonisë

1. Ceremonia e dhënies së titujve vendorë të nderit organizohet nga autoriteti që ka bërë propozimin, në bashkëpunim me Autoritetin Përgjegjës për dhënien e tyre.

2. Dhënia e titujve vendorë të nderit bëhet në çdo rast me ceremoni, e cila mund të jetë publike ose jo-publike, sipas vlerësimit të Autoritetit Përgjegjës.

3. Ceremonia e dhënies së titullit vendor të nderit, bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga miratimi i tij.

4. Si rregull, dhënia e titujve vendorë të nderit është e lidhur me përvjetorë e ngjarje të rëndësishme historike e aktuale, si dhe me festat kombëtare.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I QARKUT KUKES

5. Komisioni Keshillimor ndjek procedurën e përgatitjes së titujve vendor te nderit. Komisioni njofton autoritetin propozues për organizimin e ceremonisë për dhënien e titullit vendor të nderit, si dhe për programin, kohën dhe vendin ku do të zhvillohet ceremonia.
6. Kur propozimi miratohet nga Keshilli i Qarkut, dhe pas verifikimit të ligjshmerise se vendimit nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut, Drejtoria e Teknologjise Informacionit, Programimit dhe Statistikave përgatit **Çertifikatën** për dhenien e titullit vendor te nderit.
7. Vendimi i miratimit të titullit vendor te nderit publikohet në website-in zyrtar të Keshillit të Qarkut. Praktikat e përfunduara arkivohen.

Neni 14

Dispozita të fundit

Kjo rregullore mund të ndryshohet me aneks të veçantë.

Neni 15

Për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj Rregulloreje ngarkohet Kryetari, Sekretari i Keshillit të Qarkut Kukës, Komisioni Keshillimor, Drejtoria Juridike, Finances dhe MBNJ-se si dhe Drejtoria e Teknologjise Informacionit, Programimit dhe Statistikave.

Neni 16

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Keshilli i Qarkut Kukës.

KRYETARI
Ibsen ELEZI

